

## FLETE MIRATIMI PER PROCEDUREN ANGIOPLASTIKA KORONARE DHE VENDOSJA E STENTIT

Emri ..... Mbiemri .....

### PROCEDURE

Kjo procedure perdoret shpesh ne vend te kirurgjise (bajpasit koronar) per te trajtuar ngushtimet apo bllokimet e arterieve koronare. Ajo realizohet ne laboratorin e kateterizimit ne nje menyre te ngjashme me koronarografie.

Procedura qe do te kryhet eshte si me poshte:

Pas injektimit lokal te nje sasive te vogel te lendes anestetike, nje tub i holle (kateter) vendoset ne nje arterie ne rreze te kofshes apo ne krah. Duke perdorur rrezet X, tubi vendoset me kujdes ne arterien koronare tek e cila eshte konstatuar ngushtimi apo bllokimi. Nje fill i holle metalik vendoset nepermjet kateterit brenda ne arterien koronare pertej vendit te ngushtimit. Me pas, duke perdorur kete fill metalik si nje shine, kalohet mbi kete fill metalik nje balon ne forme te nje salciceje i cili vendoset ne vendin e ngushtimit apo te bllokimit.

Per te hapur arterien, baloni fryhet me nje leng i cili shtyp materialet qe bllokojne arterien, duke i shtyre ato tutje dhe duke hapur arterien.

Ne disa raste,

- arteria koronare mund te pesoje te cara ne pjesen e brendshme te saj ose te demtohet,
- arteria koronare mund te ngushtohet serish pas shfryrjes se balonit.

Ose

- arteria koronare mund te bllokohet serish.

Nese ndodh ndonje prej ketyre qe u permenden me siper, mund te perdoren nje ose disa stente. Stenti eshte nje tub i vogel metalik ose nje suste metalike. Stenti vendoset ne vendin e ngushtimit

- Stenti mund te ngushtohet ose te mbyllet. Kjo trajtohet zakonisht me nje angioplastike tjeter ose ne rastin me te keqme kirurgji.
- Arteria koronare mund te ngushtohet serish. Ekzistojne disa lloje te vecante stentesh, (te 4 njohur si stente te veshur me medikamente) te cilet jane me te efektshem krahasuar me stente konvencionale (te paveshur me medikamente). Ekzistojne te dhena qe keto stente ulin shanset per ringushtim gradual te arteries koronare por mund te kene nje rrezik me te larte per mbyllje te menjehershme krahasuar me stentet konvencionale dhe mund te kerkojne njer terapi me te zgjatur me barna qe ulin rezikun e mpiksjes se gjakut (aspirine dhe klopidogrel,etj).



## RREZIQET E RENDESISHME DHE ALTERNATIVAT E TRAJTIMIT

Mjeku me ka shpjeguar mua te gjitha rreziqet e rendesishme dhe problemet qe lidhen ne menyre specifike me mua si edhe ecurine e gjendjes sime ne rast se ndodhin komplikacionet e mundshme. Mjeku me ka shpjeguar edhe altemativat e mundshme te trajtimit si edhe rrezikun ne rast se nuk do te kryej proceduren.

## MIRATIMI I PACIENTIT

Une pranoj se:

Mjeku me ka sqaruar rreth gjendjes sime shendetesore dhe procedures se propozuar. Une kuptoj rreziqet e procedures, te anestezise si dhe rreziqet qe jane specifike per gjendjen time shendetesore, si edhe rezultatin e pritshem.

Mjeku me sqaroi edhe mundesite e tjera te pershtatshme te trajtimit si dhe rreziqet e tyre. Mjeku me sqaroi prognozen dhe rreziqet qe lidhen me mos-kryerjen e kesaj procedure.

Mua m`u dha mundesia te pyes mjekun dhe te paraqes shqetesimet lidhur me gjendjen time shendetesore, proceduren dhe rreziqet e saj dhe mundesite e trajtimit tim. Pyetjet dhe shqetesimet e mia u diskutuan dhe mora pergjigje te plote nga mjeku. ne e kuptoj se, ne rast te nje komplikacioni te`mundshem, mund te kern nevojte per transfusion gjaku, procedure shtese apo nderhyrje kirurgjike. Une kuptoj se procedura mund te kryehet nga nje mjek tjetere i specializuar. Mjeku me ka sqaruar se ne rast te komplikacioneve te menjehershme kercenuese per jeten gjate procedures, ato do te trajtohen ne perputhje me rrethanat.

Une e kuptoj se nuk mund te kete garanci se procedura do te permiresoje gjendjen time shendetesore.

Bazuar ne te gjitha keto,

## UNE KERKOJ OE TE KRYEJ PROCEDUREN

Emri i pacientit/ose familjarit ..... Firma .....

Data .....

*VO: Sherbimi parapaguhet. Ky sherbim perfshin vetem dy dite-qendrimi Sherbimet e tjera te lidhura me komplikacionet e mundshme pas dy dite-qendrimi paguhen sipas tabelës se cmimeve te klinikes.*

Firma e pacientit/familjarit .....